



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KUVENDI - SKUPŠTINA - ASSEMBLY**

---

**Legjislatura III**

Kryesia e Kuvendit të Kosovës

P-006

Prishtinë, më 18 shkurt 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË ME KRYETARËT E GRUPEVE PARLAMENTARE, TË  
MBAJTUR MË 18 SHKURT 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci dhe Naim Maloku, kurse munguan Eqrem Kryeziu, Xhezair Murati dhe Slobodan Petrović.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Zylfi Merxha dhe Aridan Gjini, në vend të Eqrem Kryeziut ishte deputeti Lutfi Haziri, kurse mungoi Bojan Stojanović.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

**Kryesia** i zhvilloi punimet sipas këtij

## **RENDI TË DITËS**

1. Shqyrtimi i propozimit për formën e Logos së Kuvendit të Kosovës,
2. Shqyrtimi i Projektligjeve nga Propozimi gjithëpërfshirës i Marti Ahtisarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës:
  - 2.1 Shqyrtimi i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme,
  - 2.2 Shqyrtimi i Projektligjit për privilegje dhe imunitete diplomatike,
  - 2.3 Shqyrtimi i Projektligjit për shtetësinë,
  - 2.4 Shqyrtimi i Projektligjit për policinë,
  - 2.5 Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin policor,
  - 2.6 Shqyrtimi i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit,
  - 2.7 Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore,
  - 2.8 Shqyrtimi i Projektligjit për zonat e veçanta të mbrojtura,
  - 2.9 Shqyrtimi i Projektligjit për vetëqeverisjen lokale,
  - 2.10 Shqyrtimi i Projektligjit për kufijtë administrativ komunal,

### **1. Shqyrtimi i propozimit për formën e Logos së Kuvendit të Kosovës,**

**Kryetari** i njoftoi të pranishmit me propozimin e Logos së Kuvendi, e cila do të duhet të përmbaj Stëmën e aprovuar më 17 shkurt 2008 nga Kuvendi dhe mbishkrimet “Republika e Kosovës” dhe poshtë saj “Kuvendi” në të tri gjuhët zyrtare.

**Sabri Hamiti** propozoi që poshtë Stëmës të jetë mbishkrimi “Republika e Kosovës” dhe poshtë saj “Kuvendi i Republikës ” në të tri gjuhët zyrtare dhe kështu të mund të bëhet dallimi me kuvendet komunale.

**Ardian Gjini** propozoi që poshtë Stëmës të jetë mbishkrimi “Republika e Kosovës” dhe poshtë saj vetëm “Kuvendi” në të tri gjuhët.

Opinionet dhe sugjerimet e tyre lidhur me Logon e Kuvendit i dhanë edhe Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Ramë Buja dhe Ibrahim Makolli, që janë dhënë në transkript.

**Kryesia**, pasi diskutoi lidhur me propozimin për përdorimin e Logos së Kuvendit, mori këtë

## V E N D I M

### Për përdorimin e Logos së Kuvendit

Në dokumentacionin e Kuvendit të Kosovës do të përdoret forma dhe teksti i Logos së Kuvendit, në vijim:



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KUVENDI – SKUPŠTINA - ASSEMBLY

### 2. Shqyrtimi i projektligjeve nga Propozimi gjithëpërfshirës i Marti Ahtisarit për zgjidhjen e statusit të Kosovës:

**Kryetari** i informoi të pranishmit se pas Vendimit për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, të 15 shkurtit 2008, leximi i parë i këtyre ligjeve do të bëhet brenda 24 orëve nga paraqitja formale e tyre. Me qenë se në Kuvend kanë arritur për miratim 10 ligjet e para të Pakos së Ahtisarit, ai propozoi që seanca e radhës për shqyrtimin në parim të mbahet më 19 shkurt 2008.

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, vendosi që Kuvendit t'ia propozojë rendin e ditës për seancën plenare më 19 shkurt 2008, si vijon:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme,
2. Shqyrtimi i Projektligjit për privilegje dhe imunitete diplomatike,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shtetësinë,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për policinë,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin policor,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit,
7. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore,
8. Shqyrtimi i Projektligjit për zonat e veçanta të mbrojtura,
9. Shqyrtimi i Projektligjit për vetëqeverisjen lokale,
10. Shqyrtimi i Projektligjit për kufijtë administrativ komunal.

**Kryetari** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Jakup KRASNIQI**

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**